

## Njoftim

Sot, më datë **12.05.2023**, ora **09:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Edlira Petri (Relatore);**
- 2. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 3. Emona Muçi (Anëtare);**
- 4. Blerona Hasa (Anëtare);**
- 5. Sokol Ibi (Anëtar);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr. 18 Regj.Themeltar, Datë 11.05.2023 Regjistrimi, me:

**Paditëse:** Partia e Lirisë, përfaqësuar nga Altin Kaziaj.

**I paditur:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ.

**Person i tretë:** Partia PDIU, përfaqësuar nga Shkëlqim Sulo dhe Klardi Xhemali.

**Objekti:** Ndryshimin e Vendimit nr. 90, datë 10.05.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur;  
Caktimin e Partia e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**Baza ligjore:** Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ, Nenet 4, pika 1, Nenet 9, Neni 45, Neni 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të RSH.

me Vendimin Nr.18, datë 12.05.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

## VENDOSI

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 12.05.2023.

**Tiranë, më 12.05.2023.**

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**